

# Treguesit demografikë


## Tremujori IV – 2018

**Tiranë, më 18 Shkurt 2019:** Numri i lindjeve për tremujorin e katërt 2018 rezulton 7.319, duke shënuar një rënie me 7,7 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2017. Gjatë vitit 2018, kanë lindur 28.934 foshnje, duke shënuar një rënie me 6,3 %, krahasuar me një vit më parë.

Numri i vdekjeve për tremujorin e katërt 2018 rezulton 5.458, duke shënuar një rritje prej 0,9 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Numri i vdekjeve në vitin 2018 është 21.804 persona, duke shënuar një rënie me 1,9 %, krahasuar me një vit më parë.

Shtesa natyrore e popullsisë në tremujorin e katërt 2018 është 1.861 dhe rezulton me rënie prej 26,2 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2017. Ky tregues për vitin 2018 është 7.130 dhe rezulton me rënie 17,4 %, krahasuar me një vit më parë.

**Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë**




Në tremujorin e katërt 2018, shtesa natyrore e popullsisë, për 12 qarqet e Shqipërisë, shënon vlerën më të lartë në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 1.089 numrin e vdekjeve. Me shtesë natyrore të lartë paraqitet qarku i Elbasanit, me 273 lindje më shumë se vdekje, pasuar nga qarku i Durrësit, me 248 lindje më shumë se vdekje.

Shtesa natyrore e popullsisë, në tremujorin e katërt 2018 regjistron vlerë negative vetëm në tre qarqe (Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë) ku vlera më e ulët shënohet në qarkun e Korçës, në të cilin numri i vdekjeve tejkalon me 154 numrin e lindjeve.

Qarku i Gjirokastrës ka rezultuar me vlerë negative të shtesës natyrore të popullsisë gjatë gjithë vitit, ku numri i vdekjeve kalon me 217 numrin e lindjeve, për vitin 2018.

Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T4 – 2018



**Lindjet**

Gjatë vitit 2018, të gjitha qarqet e vendit kanë pësuar rënie të numrit të lindjeve në krahasim me vitin 2017.

Në tremujorin e katërt 2018, numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës me 2.423. Në tremujorin e katërt 2018, lindjet në Qarkun e Tiranës shënuan një rënie me 4,2 % në krahasim me tremujorin e katërt 2017.

Numri më i ulët i lindjeve, në tremujorin e katërt 2018 regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, me 138 lindje, me një rënie prej 12,7 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2017.

Dhjetë qarqe pësuan rënie të numrit të lindjeve në tremujorin e katërt 2018, krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Rënie më të madhe në përqindje të lindjeve gjatë kësaj periudhe e shënon qarku i Korçës me 21,8 % dhe qarku i Vlorës me 19,1 %.

Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve

Nr.	Qarqet	2017	2018	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2017	T 4 - 2018	Ndryshimi tremujor në %
	<b>Shqipëria</b>	<b>30.869</b>	<b>28.934</b>	<b>-6,3</b>	<b>7.931</b>	<b>7.319</b>	<b>-7,7</b>
1	Berat	1.319	1.184	-10,2	328	314	-4,3
2	Dibër	1.715	1.564	-8,8	443	414	-6,5
3	Durrës	3.270	3.086	-5,6	857	762	-11,1
4	Elbasan	2.996	2.927	-2,3	740	781	5,5
5	Fier	3.015	2.636	-12,6	781	655	-16,1
6	Gjirokastrër	566	527	-6,9	158	138	-12,7
7	Korçë	1.956	1.634	-16,5	499	390	-21,8
8	Kukës	1.091	952	-12,7	255	217	-14,9
9	Lezhë	1.501	1.362	-9,3	406	357	-12,1
10	Shkodër	2.043	1.976	-3,3	483	495	2,5
11	Tiranë	9.680	9.583	-1,0	2.529	2.423	-4,2
12	Vlorë	1.586	1.388	-12,5	423	342	-19,1
	*Të panjohur	131	115		29	31	

\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja, mungon.

**Vdekjet**

Në dhjetë nga dymbëdhjetë qarqet e vendit, numri i vdekjeve ka pësuar rënie në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017.

Numri më i lartë i vdekjeve për tremujorin e katërt 2018 regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 1.334 vdekje, me një rënie prej 0,3 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2017. Numri më i ulët i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 102 vdekje, me një rënie prej 28,2 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2017.

Pesë qarqe pësuan rënie të numrit të vdekjeve në tremujorin e katërt 2018, krahasuar me tremujorin e katërt 2017. Rënia më e madhe në përqindjen e vdekjeve gjatë këtij tremujori regjistrohet në qarqet e Kukësit dhe Gjirokastrës, në krahasim me tremujorin e katërt 2017.

**Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve**

Nr.	Qarqet	2017	2018	Ndryshimi vjetor në %	T4 - 2017	T 4 - 2018	Ndryshimi tremujor në %
	<b>Shqipëria</b>	<b>22.232</b>	<b>21.804</b>	<b>-1,9</b>	<b>5.408</b>	<b>5.458</b>	<b>0,9</b>
1	Berat	1.223	1.150	-6,0	276	293	6,2
2	Dibër	920	914	-0,7	186	228	22,6
3	Durrës	1.955	2.074	6,1	482	514	6,6
4	Elbasan	2.206	2.188	-0,8	549	508	-7,5
5	Fier	2.500	2.484	-0,6	603	647	7,3
6	Gjirokastrë	821	744	-9,4	199	171	-14,1
7	Korçë	2.197	2.089	-4,9	528	544	3,0
8	Kukës	610	502	-17,7	142	102	-28,2
9	Lezhë	1.018	975	-4,2	244	268	9,8
10	Shkodër	1.875	1.811	-3,4	454	429	-5,5
11	Tiranë	5.249	5.174	-1,4	1.338	1.334	-0,3
12	Vlorë	1.633	1.673	2,4	404	416	3,0
	<i>*Të panjohur</i>	25	26		3	4	

\* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja nuk është i njohur.

# Shënime metodologjike

## 1. Lindjet

### *Të dhënat e lindjeve*

Të dhënat e lindjeve sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të lindjeve*

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

## 2. Vdekjet

### *Të dhënat e vdekjeve*

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të vdekjeve*

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

**Përkufizime:**

**Shtesa natyrore e popullsisë:** Shpreh rritjen / rënien e popullsisë si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj gjatë një periudhe kohë. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

**Lindje e gjallë:** Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

**Vdekje:** Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale pa aftësinë e ringjalljes).

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.